

Njoftimi i Ftesës për Propozim

Organizatori: Fondacioni “Dyrrah City Football Academy”

Projekti/kontrata: Projektimi, ndërtimi dhe zhvillimi i Qendrës Sportive “Dyrrah City Sports Centre”, për sportet e tenisit dhe basketbollit

Publikuar më: 28 Maj 2025

1. Fondacioni “Dyrrah City Football Academy”, këtu “Fondacioni”, zhvillon projektin “Projektimi, ndërtimi dhe zhvillimi i Qendrës Sportive “Dyrrah City Sports Centre”, për sportet e tenisit dhe basketbollit”, i cili ka për qëllim zgjerimin e aktiviteteve të Fondacionit në sportet e tenisit dhe basketbollit.
2. Fondacioni, i themeluar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, si edhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 580, datë 11.10.2023, të ndryshuar, u caktua që pronat shtetërore me numër pasurie 79/1, me sipërfaqe 99’770 m², dhe 80/1, me sipërfaqe 104’580 m², si dhe nr. 301/2, me sipërfaqe 3 120 (tre mijë e njëqind e njëzet) m² pjesë e zonës kadastrale nr. 8517, Bashkia Durrës, në zonën e Spitallës, të përdoren për ndërtimin dhe zhvillimin e kompleksit të Akademisë së Futbollit Durrës dhe të ambienteve sportive dhe çdo shërbimi të nevojshëm, në funksion të promovimit dhe zhvillimit të sportit të futbollit, tenisit dhe sporteve të tjera në Republikën e Shqipërisë, si dhe për realizimin e funksioneve të fondacionit, i cili i menaxhon këto komplekse.
3. Kjo procedurë synon përzgjedhjen e një partneri privat për ndërtimin dhe zhvillimin e qendrave të tenisit dhe basketbollit brenda Qendrës Sportive të Fondacionit “Dyrrah City Football Academy” në Durrës. Objektivat e partneritetit janë ndër të tjera: ndërtimi i dy infrastrukturave sportive (për sportet e tenisit dhe basketbollit) sipas standardeve ndërkombëtare; si dhe zhvillimi i një modeli të qëndrueshëm biznesi që siguron të ardhura të vazhdueshme për Fondacionin.
4. Përzgjedhja do të kryhet nëpërmjet një procedure konkurruese, siç specifikohet në seksionin “Udhëzimet për Kandidatët”, në Ftesën për Propozim, bashkëngjitur këtij njoftimi dhe është e hapur për të gjithë subjektet e interesuar.
5. Propozimi do të përbëhet nga formularët e kërkuar, të ndarë në dy zarfe, siç detajohet në Udhëzimet për Kandidatët, në Ftesën për Propozim.
6. Propozimi duhet të dorëzohet në një zarf të mbyllur, në adresën:

Fondacioni “Dyrrah City Sports Centre”
Rr. “Petrë Kokalari”, Nr. 57
Kompleksi Sportiv
1012, Tiranë
Ilvana Dedja – Person Kontakti
00355692070412
info@dcfa.al
www.dcfa.al

në ose përpara datës 19/06/2025, ora 13:00.

7. Propozimet e marra pas afatit të sipërpërmendur do të refuzohen.
8. Propozimet do të hapen publikisht, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të kandidatëve dhe kujtdo që dëshiron të marrë pjesë në adresën, datën dhe orën e sipërpërmendur.

Për Fondacionin,

Gjergj Ndoci
Drejtör Ekzekutiv